



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 214/11 Prot.

Pogradec, më 30.01. 2023

**VENDIM**

NR. 06, DATË 26.01. 2023

**“PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE TË PAJISURA ME LEJE NDËRTIMI,  
PUNIMET E TË CILAVE KANË FILLUAR PREJ MË SHUMË SE DHJETË  
VJETËSH DHE ENDE NUK KANË PËRFUNDUAR, SIPAS PROJEKTIT TË  
MIRATUAR”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja b, neni 23 pika 14, neni 54, neni 55, të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative” Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, , Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pas relacionit të paraqitur nga drejtoria e P.K.ZH.T, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë procedurën standarte të veprimit në Bashkinë Pogradec “Për trajtimin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi, punimet e të cilave kanë filluar prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende nuk kanë përfunduar, sipas projektit të miratuar”, sipas aneksit bashkëlidhur (aneksi 1).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e bashkisë sipas detyrave përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**  
**Sotiraq MANGËRI**